

AKTI I THEMELIMIT
PËR SHOQËRINË” K11 UNLIMITED SHPK
FORMIMI I SHOQËRISË

Sot në Tiranë më datë 11/11/2024 themelohet shoqëria tregtare me pergjegjësi të kufizuar e emërtuar

“**K11 UNLIMITED**” shpk me vullnet të lirë të ortakut të vetëm:

Z. **Besmir Murati** i biri i Bashkimit i datëlindjes 21/11/1985 lindur në Peshkopi Dibër banues në Tiranë madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr personal **-I51121011M**

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë do te jetë në rrugën “3 dëshmorët” pallatet Lorena Kati 0, Njësia nr.8, Tiranë

Me vendim të ortakëve mund të ngrihen edhe filiale degë apo seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë, në përputhje me ligjet dhe legjislacionin në fuqi.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria Tregtare “**K11 UNLIMITED**” SHPK do ta përmbush objektivin e veprimtasë të saj në një afat të pacaktuar.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali Themeltar i Shoqërisë së Thjeshtë është i përbërë nga kontributi i anëtarëve themelues në vlerën 1000 (njëmijë) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga Anëtarët Themelues në këtë mënyrë:

- Ortaku z. **Besmir Murati** zotërues i një kutote me vlerë nominale të barabartë me 1000 (njëmijë) lekë, që përbën 100% (njëqind për qind) të vlerës të kapitalit të shoqërisë.

Vlerësimi i kapitalit themeltar është bërë nga anëtarët themelues, me rastin e themelimit të kësaj kontrate themelimit dhe është nënshkruar prej tij.

OBJEKTI I VEPRIMTRISË

.1 Objekti i veprimtarisë të shoqërisë është:

a) Shërbime të ndryshme në fushën e Burimeve Njerzore si ndermjetësim në tregun e punës, formimin profesional, rekrutimin e punëtoreve/punëmarrësve të huaj dhe vendas, trajnime të ndryshme, shërbime në terren, konsultime ligjore dhe profesionale.

b) Tregtinë me shumicë dhe pakicë imort -eksport të çdo lloj artikulli të ndryshëm industrial, të produkteve industrial si makineri paisje, detergjentëve që nevojiten në fushën e pastrimit dhe dezinfektimit dhe higjenes



ambientale si zyra shtëpi mjete motorike apo higjenës personale , të paisjeve të ndryshme apo aksesoreve të ndryshëm që i shërbejnë ketij qëllimi. Ofrimin e shërbimeve për pastrimin profesional të zyrave, banesave, hoteleve, fasadave, mjeteve motorike tapicerive te ndryshme.

c) Tregtinë me shumicë dhe pakicë të produkteve industriale te veshjeve dhe veshmbathjeve për burra ,gra, dhe fëmijë, veshjeve të lëkures , të kepecëve ,copa të çfardo lloj materiali produkti tekstil aksesor të ndryshëm veshjesh, fije dhe aksesorë rrobaqepsie, paisje dhe artikuj sportiv, produkte kozmetike, parfumeve, bizhuteri, artikuj për dhurata kinkaleri, produkte kancelarie, etj

d) Prodhim për shitje të stampimeve te gjitha llojeve, për qëllime marketingu, shitje të materialeve të promocionit, import- eksport të materialeve të nevojshme për të gjitha llojet e stampimeve, shtypshkrimeve ,amballazhit, import- eksport të makinerive dhe pjesëve te këmbimit për industrinë tipografike, linjave të prodhimit dhe kompjuterave.

8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim te ortakut te vetëm ose Asamblesë së përgjithshme të ortakëve

ORGANET DREJTUESE TË SHOQERISË

1. Organet drejtuese të shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e cila është përgjegjese per marrjen e vendimeve të më poshtëme:
 - a- Per ndryshime ne statut.
 - b- Emërimin dhe shkarkimin e administratorit ose administratorëve.
 - c- Miratimin e bilancit dhe pasqyrave financiare vjetore.
 - d- Zmadhimin apo zvoglimin e kapitalit.
 - e- Riorganizimin apo prishjen e shoqërisë.

Administrator i përgjithshëm i shoqërisë është **Z. BESMIR Murati** me numër identifikimi **I51121011M** i datëlindjes 21 /11/1980, me afat 5 vjecar me të drejte ripërtëritje.

BAZA LIGJORE

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet ne ligjin 9901 datë 14.04.2008” Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Ky akt Themelimi u hartua në tre kopje me të njeften fuqi ligjore .

Nje kopje ruhet në selinë e shoqërisë.

Ortaku i vetëm

Besmir Murati

